



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeno / Predato Received / Delivered	23. 08 2023	3 viti god year	
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHCK	5793	2023	113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.963/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje: Ardita Haxhnikaj - Demi, kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shaban, anëtarë; me Ardita Percuku-Shyti, Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional, si procesmbajtëse, sipas ankesës me numër A.nr.963/2023, të datës 14.07.2023, të parashtruar nga ankuesi _____, kundër organit të punësimit- Komuna e Pejës, në çështjen juridike "Shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafin 3; nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7, të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.08.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.963/2023, e datës 14.07.2023, e parashtruar nga ankuesi _____

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, _____ (tutje vetëm ankuesi), i punësuar në Komunën e Pejës, më datë 14.07.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se klasifikimi i ankueses me koeficient 3.96 është në kundërshtim me dispozitat materiale në fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme Këshilli), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 21.07.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë pranë Komunës së Pejës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 26.07.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i provave të lëndës si dhe shqyrtimi i pretendimeve ankimore, konstatoi se ankesa e ankuesit është e palejuar, sepse:

Nga shkresat e lëndës konstatohet fakti se ankuesi është i punësuar në Komunën e Pejës dhe se i njëjti sipas Akt të Emërimit të datës 04.01.2012, ushtron pozitën e punës "Zyrtar i Z.K.GJ.C", në Drejtorinë për Administratë, me koeficient të pagës pesë (5), sipas sistemit të vjetër të pagave.

Më tej nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesi pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, gjegjësisht në listën e pagave për muajin shkurt pozita e tij e punës është kategorizuar në kategorinë Profesional 3, duke realizuar koeficient të pagës tre pikë nëntëdhjetë e gjashtë (3.96) euro.

Ankuesi, me datë 14.07.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se Komuna e Pejës, pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, e ka kategorizuar ankuesin në Kategorinë Profesionale 3, me koeficient të pagës tre pikë nëntëdhjetë e gjashtë (3.96), ndërsa i njëjti ka kërkuar ndryshimin e koeficientit nga kategoria aktuale me koeficient 3.96 në kategorinë Profesional 2, me koeficient të pagës pesë (5).

Për pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit i analizoi dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2, paragrafi 1, në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: "1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj", dhe nenin 14, paragrafi 3, të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcën Nr. 10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik. Në këtë rast në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës, ka gjetur ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Komuna e Pejës ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procesimi i pozitës së ankuesit në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së saj të punës, në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i ekuivalencës së sistemit të vjetër me sistemin e ri të koeficienteve, të përcaktuar me Vendimin Nr. 04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, duke qenë së me nenin 29 të Rregullores (QRK), Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe më pikën 5 dhe 6 të Vendimit Nr. 04/128, të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, institucionet e administratës publike janë të obliguara që ta përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se nëntë (9) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, gjegjëshit deri me datë 30.09.2023. Kolegji i Këshillit vlerëson së ankesa e ankueses, për



kategorizimin e pozitës së saj në kategorinë "Profesional 2" është e parakohshme. Si e tillë, në këtë fazë, nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim merititor. Rrjedhimisht, e njëjta, është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, theksuar si me sipër, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitave të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës dhe afatit të theksuar më lart, ankuesit do t'i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankesës për klasifikimin e pozitës së saj të punës.

Kështu që, mbështetur në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, i Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.963/2023.

Ardita Percuku-SHYTI


Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI,


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Pejës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

